



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
BORDI DISIPLINOR**

**Nr. (•)Vendimi**

**Tiranë, më (•)**

**V E N D I M**

**BORDIT DISIPLINOR I DHOMËS KOMBËTARE TË NOTERISË**

i përbërë nga :

<b>Jonida Gaba:</b>	<b>Kryetare</b>
<b>Entela Memishaj Shehaj:</b>	<b>Sekretar/Anëtar</b>
<b>Irena Laha:</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Marjana Tutulani Semini:</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Merita Prifti:</b>	<b>Anëtar</b>

në mbledhjen e mbajtur më datë (•), mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen me të dhënat si më poshtë:

**OBJEKTI:** Pezullimi nga detyra i noterit (•)

**BAZA LIGJORE:** Neni 56, shkronja "a", nenet 57, 58, 59, pika 1, dhe 60 të Ligjit Nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", i ndryshuar.

**BORDI DISIPLINOR**

- më datë (•), administroi kërkesën e Ministrit të Drejtësisë nr. (•)Prot., datë (•) për informim/kërkesë për pezullimin e noterit (•), e cila i referohej vendimit nr.(•)datë (•)i cili ka caktuar masën e sigurisë "arrest me burg" me afat 45 ditë ndaj shtetasit (•);
- në kushtet kur afati 45-ditor i masës së sigurimit rezultonte i përfunduar në datën e njoftimit të Bordit Disiplinor, Bordi iu drejtua me kërkesë për informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor (•);
- më datë (•), administroi informacionin zyrtar nga autoritetet përgjegjëse lidhur me caktimin a masës së sigurimit "arrest në shtëpi", konkretisht, shkresën nr. (•)Prot., datë (•)të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor (•) përmes së cilës i përcillen Bordit Disiplinor Vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor (•) si vijon: vendimi nr. (•)Akti, datë (•) për caktimin e masës së sigurimit personal "arrest në shtëpi" ndaj shtetasit (•) për kryerjen e veprës penale "Shpërdorim detyre" e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; dhe
- duke marrë në konsideratë edhe kërkesën e Ministrit të Drejtësisë për pezullimin e noterit (•) sipas shkresës së sipërcituar nr.(•)Prot., datë (•);

bazuar në nenet 56 – 60 të Ligjit Nr. 110/2018, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”,

**VENDOSI:**

1. Pezullimin nga detyra të noterit (•), Noter i Dhomës së Noterisë (•), për gjithë periudhën e kohëzgjatjes së masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, në bazë të nenit 56, shkronja “a”, të Ligjit Nr. 110/2018, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”;
2. Vendimi i njoftohet noterit (•) dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor (•);
3. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për nxjerrjen e urdhrit përkatës për zbatimin e këtij vendimi;
4. Ngarkohet Dhoma Kombëtare e Noterisë për publikimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e tij në regjistrin përkatës;
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në gjykatën kompetente administrative të shkallës së parë Tiranë, brenda 45 diteve nga e nesërmja e njoftimit të tij;
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë (•), në Tiranë.

**Bordi Disiplinor:**

**Jonida Gaba**

**Entela Memishaj Shehaj**

**Irena Laha**

**Marjana Tutulani Semini**

**Merita Prifti**